



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Psikolinguistikë dhe metodologji të mësimdhënies së gjuhës së huaj

Ngarkesa: 6 kredite, 30 orë leksion/ 30 orë seminar
Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave në Mësuesi e gjuhës frënge për arsimin e mesëm të lartë
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Aftësimi dhe pajisja e studentëve me njohuri e shprehje të mësimdhënies së gjuhës frënge në grupmosha të ndryshme.

Të njohë dhe të shfrytëzojë në funksion të objektivave të mësimdhënies karakteristikat psikologjike të grupmoshave të ndryshme, personalitetet e nxënësve me qëllim motivimin e tyre.

Të njohin teoritë e të nxënit dhe zbatimin e tyre në mësimdhënie/nxënien e gjuhës frënge.

Aftësimi i studentëve për të zbuluar dhe kuptuar marrëdhëniet që krijohen në klasë dhe shfrytëzimi i tyre në funksion të arritjes së objektivave të mësimdhënies/nxënies së gjuhës së huaj.

Aftësimi i studentëve për të analizuar situatën aktuale të mësimin të gjuhës së huaj në sistemin tonë edukativ dhe për të reflektuar mbi kompetencat profesionale që duhet të zotërojnë një mësues për t'u bërë ballë kërkesave aktuale të zhvillimit të shoqërisë

Objektivat specifike lëndore:

Aftësimi i studentëve në konceptimin e një ore mësimi duke respektuar të gjitha etapat dhe qasjet pedagogjike

Aftësimi i studentëve për të përzgjedhur dhe prodhuar materiale didaktike në funksion të objektivave të modulit dhe në përshtatje me nevojat e nxënësve.

Të venë nxënësin me personalitetin e tij në qendër të procesit mësimor.

Të aftësohen studentët për të njohur e kuptuar natyrën dhe mekanizmat e procesit të të nxënit nga nxënësit me të cilët ata punojnë.

Të aftësohen studentët në shfrytëzimin e faktorëve psikologjikë dhe teoritë e mësimdhënies/nxënies në funksion të përvetësimit cilësor të gjuhës së huaj.

Të aftësohen studentët në njohjen dhe përdorimin e dokumentave të Këshillit të Europës lidhur me mësimin e gjuhëve të huaja.

Aftësimi i studentëve në përvetësimin e kompetencës ndërkulturore dhe përçimin e saj tek nxënësit në zhvillimin e dialogut ndërkulturor.

Aftësimi i studentëve me metodologjinë e vlerësimit të nxësve në gjuhë të huaj dhe korrigjimin e gabimeve.

Aftësimi i studentëve në gjetjen e teknikave dhe strategjive për motivimin e nxënësve në mësimin e gjuhës frënge.